

NJOFTIM PËR KONKURRIM

Në bazë të planit të arsimit për vitin 2015, të miratuar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA me urdhër nr.890, datë 24.12.2014 “Për miratimin e planit të arsimit institucional dhe funksional në institucionet arsimore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për vitin 2015-2016”, **plani C-2**, është planifikuar hapja e Kursit Fillestar të Nënoficerit, në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson”, në periudhën **12.10.2015 – 13.11.2015**.

Mbështetur në udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr.15, datë 17.11.2014 “Për procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktivë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, njoftohet personeli Ushtar/Detar IV, i interesuar për të ndjekur Kursin Fillestar të Nënoficerit, në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson”, në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçjes.

Kriteret e konkurrimit për të ndjekur Kursin Fillestar të Nënoficerit:

Ushtari/Detari IV për të ndjekur Kursin Fillestar të Nënoficerit duhet të plotësojë këto kriteret:

- Në momentin e aplikimit të mos jetë më shumë se 32 vjeç;
- Të jetë vlerësuar jo më pak se “mbi mesatar” në dy vlerësimet e fundit vjetore (vlerësimet i referohen vlerësimit të superiorit);
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar;
- Të jetë vlerësuar kalues në testin e përgatitjes fizike;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe 160 cm për femrat;

Aplikimi:

- Kërkesa për të marrë pjesë në konkurrim i adresohet komandës së repartit, ku ushtari/detari IV është duke kryer shërbimin.
- Kërkesa do të bëhet sipas formatit dhe modaliteteve të trajtuara në Aneksin A.
- Së bashku me kërkesën aplikanti duhet të paraqesë edhe raportin e ekzaminimeve mjekësore.
- Kryerja e ekzaminimit mjekësor do të kryhet në periudhën **20.06.2015-20.07.2015** në Spitalin Ushtarak të Forcave të Armatosura.
- Procesi i aplikimit të përfundojë deri më datë **20.07.2015**.

Zhvillimi i konkurrimit:

Zhvillimi i konkurrimit përfshin:

- Testimin fizik;
- Testimin intelektual;
- Testimin e njohurive të gjuhës angleze
- Testimin psikologjik;
- Vlerësimin e titujve të meritës;

Kërkesë: Për të marrë pjesë në konkurrim për ndjekjen e Kursit Fillestar të Nënoficerit.

Drejtuar: Komandantit të repartit _____
Nr. i repartit

Unë i nënshkruari Ushtar/Detar IV _____, _____, _____
Emër Atësi Mbiemër

lindur më _____, _____, _____
data muaji viti

banues në rrugën _____, _____, _____
rruga pallati/apartamenti qyteti/fshati

me detyrë _____, _____
detyra funksionale reparti nr.

Mbështetur në udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr.15, datë 17.11.2014 “Për procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktivë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe duke qenë i bindur se i plotësoj kërkesat e ligjit 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura” dhe kriteret e nevojshme, kërkoj të marr pjesë në konkurrim për të ndjekur Kursin Fillestar të Nënoficerit, në Akademinë e Nënoficerëve “Thomson”.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se nuk jam në proces gjyqësor ose nën hetim nga prokuroria për ndonjë çështje të caktuar.

_____, _____
Vendi data

Emri, mbiemri dhe firma e aplikuesit